



Gjinia në kampanjën zgjedhore 2020, në fokusin e mbledhjes së parë të ASHMA



Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audio vizuele më 25 mars mbajti mbledhje publike, ku për shkak të situatës me korona virusin u mbajt përmes një video konference. Në mbledhje drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski, bëri një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Programin Vjetor për punën e tremujorshit të kaluar. Të pranishmëve iu dha mundësia të dëgjojnë për aktivitetet lidhur me mbikëqyrjen ndaj transmetuesve, operatorëve të komunikimit elektronik të rrjetit publik, botuesit e medias së shkruar, masat e shqiptuara vërejtje publike, punimet hulumtuese, aktivitetet në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në mbledhje ishin prezantuar dhe rezultatet e analizës e pyetjeve gjinore dhe mënyrën e paraqitjes dhe prezantimit të grave dhe burrave në lajmet e shërbimeve televizive nacionale – MRT1, MRT2, Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel dhe Telma, gjatë kohës së kampanjës zgjedhore për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare në 2020. Analizën për nevojat e Agjencisë e përgatiti Instituti për demokraci „Societac civilis“ nga Shkupi.

Rezultatet e analizave treguan se mbulimi mediatik i kampanjës zgjedhore haptazi anonte në promovimin e burrave-kandidatë për deputet dhe këndvështrimi mashkullor dhe ekspertiza rreth zhvillimit gjatë zgjedhjeve. Kandidatet ishin të vendosura nën hijen e kolegëve burra, kishin më pak qasje në forma të ndryshme gjatë promovimit të platformave të tyre dhe profileve të tyre, dhe mesazheve qëndronin anonim, të padëgjura dhe të papara nga publiku. Në artikujt e fushatës zgjedhore, gjithësej nga 134 përfaqësues të partive politike, 128 ishin burra, përkundër 6 grave. Gjatë transmetimeve të emisioneve ditore me tematikë zgjedhore si subjekt primar paraqiten 86% burra, përkundër 14% gra. Analiza kualitative e përmbajtjes së emisioneve informative ditore përmes së gjithash tregoi se nga 9 artikuj prezantimi i grave ishte seksualisht e objektivizuar derisa në 6 aktivitete ishte vërejtur stereotipe në bazë të roleve gjinore të pargjykuara nga shoqëria. E gjithë analiza është në dispozicion në faqen e internetit www.avmu.mk.

Mbështetja finansiare për kompensimin e mjeteve për licencë për radio transmetim dhe TV

Këshilli i Agjencisë, bazuar në Vendimin e Qeverisë nga paketa e pestë e masave ekonomike ku u siguroa ndihmë finansiare për transmetuesit në vlerë prej 50.000.000,00 denar, në seancën e 7-të mbajtur më 2 mars, vendosi të ndalojë të gjitha procedurat e inicuar për heqjen e lejeve bazuar në mospagimin e tarifës vjetore për radiotransmetim dhe TV. Njëkohësisht ishte vendosur të mos inicohen procedurat të reja për heqjen e lejeve për shkak të mospagimit të tarifës për vitin 2021.

Të gjithë transmetuesve, të cilët kishin kryer komplet ose pjesërisht pagesë të tarifës për leje të transmetimit në radio ose television për vitin 2021, Agjencia ia ktheu fondet Transmetuesve të cilëve iu dha faturë për tarifë vjetore për licencë, dhe nuk e kanë paguar, si dhe transmetuesit që sapo do të dorëzohet fatura, nuk kanë obligim për pagim për shkak se obligimi i tyre në përgjithësi është përmbushur nga mjetet finansiare të paketës nga masat ekonomike.

Po ashtu, Agjencia i informoi transmetuesit se faturat e dhëna për tarifën vjetore për licencë për transmetim në television dhe radio për 2021 shërbejnë vetëm për të dhënat e tyre dhe për të njëjtat nuk mund të kryejnë kthim të tatimit të vlerës së shtuar, për shkak se janë paguar kesh nga mjetet e miratuara me Vendim të Qeverisë së RMV dhe nga Drejtoria e të ardhurave publike Agjencioni në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i këtyre aktiviteteve do të paraqes raport tek Qeveria e RMV dhe tek Drejtoria e të ardhurave publike për shfrytëzimin e mjeteve nga paketa e masave ekonomike, ndërsa mjetet e mbetura të papërdorura do të kthehen në dhogari të Buzhetit të RMV.

Formularë të rinj për raportimin e transmetuesve për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në licencën për transmetim RSH dhe TV

Këshilli i Agjencisë në seancën e 7-të, mbajtur më 1 mars miratoi formular të rinj për raportimin e transmetuesve zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në licencat për transmetim në radio dhe television. Transmetuesit në përputhshmëri me dispozitat nga neni 15 paragrafi 5 nga Ligji për media, ka për detyrim jo më vonë se 31 mars 2021, në Agjencia me formular të veçantë të paraqesin raport për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në licencën për radio dhe TV transmetim, veçanërisht për konceptin programor. Në origjinën e raportit paraqitet dhe informacioni për mjete teknike përmes së cilave emetohet ose rrimetohen shërbimet programore brenda dhe jashtë shtetit. Formularët e rinj për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara për licencën për radio dhe TV transmetim janë në dispozicion në www.avmu.mk



NEWSLETTER

Transmetuesit

Mbikëqyrja e programit për respektimin e rregullave për mbrojtjen e popullatës minorene, Agjencia kreu ndaj serialit „Angjeli“ i cili transmetohet në TV Sitel. Gjatë mbikëqyrjes programore u konstatua se shfaqja dhe repriza të serialit të luajtur „Angela“ ishin gabimisht të kategorizuara dhe të shënuara si një programi i kategorisë së Dytë (+8), ndërsa repriza ishte transmetuar në periudhë kohore të papërshtatshme të mesnatë..

Mbikëqyrja e rregullt programore dhe administrative për më shumë detyrime ligjore është kryer ndaj TV 24 Vesti, TV Alfa, Nasha TV, TV Telma, TV Alsat-M, TV Kanal 5, TV Alfa, TV Sitel dhe shërbimet programore MRT 1, MRT 2, MRT 3, MRT 4 dhe MRT 5. Objekt i mbikëqyrjes ishin rregullat

Gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizive, mbrojtja e popullatës minorene, shfrytëzimin e linjave telefonike me vlerë të caktuar dhe votimit telefonik, transmetimin e lojërave të fatit dhe sigurimin e kuizeve ose forma të tjera të pjesëmarrjes në lojra ose nevoja e përdorimit të gjuhës në programet, transmetim ditor jo më pak se 12 orë program dhe transmetim më së pakti 30%, ndërsa shërbimi publik të paktën 40% program popullor, publikimi i përshtypjeve, informacione që duhet të bëhen prezente për publikun dhe shpallja e identifikimit të transmetuesit..

Në mbikëqyrje ishte konstatuar shumë shkelje. Shërbimet programore MRT 2, MRT 3, MRT 4 dhe MRT 5 nuk i siguruan informacionet që duhet të bëhen të pranishme për përdoruesin, gjegjësisht të dhënat për adresën e selisë të dhëna për kontakt, dhe të dhëna për organin rregullator. Në programin e MRT 3 dhe MRT 4, në pjesën e transmetimit të programeve, nuk ishin botuar të dhënat për autorët që i përgatisin përmbajtjet, redaksinë, origjinën dhe datën e prodhimit të veprave, emrin e medias nga ku është marrë përmbajtja dhe të dhëna të tjera që janë të obliguar ti transmetojnë në vendin adekuat për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Shërbimi programor MRT 4, nuk transmetonte më së pakti 40% program muzikë popullore krijuar si vepra audiovizive maqedonase, gjatë një dite. Në MTV 2 dhe MTV 5 është konstatuar shkelje e obligimeve për mbrojtjen e popullatës minorene, gjegjësisht janë transmetuar njoftime promovuese për programet e luajtura pa u shënuar me sinjalizimin për mbrojtjen e minorenëve. Në programin TV Alfa pjesa e parë e episodit nga seriali i luajtur „Vistina ili llagi“ ishte e emetuar në gjuhën burimore serbe, pa u siguruar përkthimi në gjuhën maqedone.

Pas shqiptimit të masës vërejtje publike, drejtuar për mosrespektim të rregullave për emetimin e komunikimit komercial audiovizuel, është kryer mbikëqyrje e programit kontrollues ndaj TV Zdravkin nga Velesi. Mbikëqyrja tregoi që në tërësi është vepruar në bazë të vendimit për shqiptim të masës vërejtje publike.

Media e shkruar

Me qëllim të përcaktimit nëse në mediat e shkruara Bukuria dhe shëndeti dhe Doktorin Rus janë publikuar të dhëna për impresium, Agjencia kreu mbikëqyrje të çrregullt. Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se në botimin Bukuria dhe shëndeti nr.147 nuk është plotësuar në tërësi ky obligim nga Ligji për media, gjegjësisht nuk janë publikuar të dhënat për adresën e shtypshkronjës.

Operatorët e rrjetit të komunikimit elektronik

Për detyrimet që lidhen me regjistrimet e shërbimit programor në Agjencionin dhe titlimin e programeve që i ritransmetojnë operatorët është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj operatorëve Kablekall nga Kërçova, Skrebell dhe Signal-Net, nga Kumanova dhe Telent Kom nga Tetova. Nga mbikëqyrja u konstatua se operatori Signall-Net nga Kumanova e ritransmeton shërbimin programor „ZICO TV“ që nuk është i mbuluar me licencë për regjistrim të shërbimit programor nga Agjencia.

Ndaj operatorit Infel-KTV nga Ohri, Agjencia kreu kontroll të shërbimit programor që të konstatoi nëse operatori ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike e udhëzuar për ritransmetim të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjencion, në përputhje me nenin 141 nga LSHMAAV. Mbikëqyrja tregoi se operatori Infel- KTV në tërësi ka vepruar sipas vendimit udhëzues të Agjencisë.



NEWSLETTER

Shqiprimi i vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të për vitin 2021 e mbajtur me datë 16 masr, në bazë të raporteve nga mbikayrjet e realizuara ku janë konstatuar shkelje ligjore, solli 12 vendime për shqiptimin e masave vërejtje publike.

Masë ërejtje publike për mos publikimin e impresumit i është shqiptuar shërbimit programor MRT3, MRT4 dhe TV Kanal Macedoija. Për mos respektimin e rregullave për mbrojtjen e publikut minoren shqiptim i masës vërejtje publike i është shqiptuar mrt2, mrt 5 dhe TV Iris. Informacione të cilat duhet du bëhen publike shfrytëzuesve nuk e siguruan MRT2, MRT3 dhe MRT5, ndërsa obligimin për plotësimin e kotës për program të prodhuar programor si vepra maqedonase audio dhe audiovizuale nuk e plotësuan TV Kompani21-M dhe MRT4.

Për të gjithë televizionet pas skadimimit të afatit për pajtueshmërinë ligjore, do tu bëhet mbikqyrje kontrolluese për tu vërtetuar nëse kanë vepruar sipas shqiptimit të masave vërejtje publike.

